



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT**

Ballsh, më _____._____.2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

*Objekti i prokurimit: “**Rikonstruksion i rrugëve të Fshatit Gadurove**”*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45233120-6 - Punime ndërtimi për rrugë

*Vlera e fondit limit: **47.436.005,95** (dyzetë e shtatë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesë presje nëntëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH.***

Bazuar në nenin 53, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 67, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga AK Bashkia Mallakastër.

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhëri përkatës i prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesës (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 26, 29 dhe 30, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26 dhe 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku përcaktohet se: ” Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – Punë Publike - ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetary.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se vlera e kontratës) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohej. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këtë procedurë është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jete minimalisht sa vlera e parashikuar e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi,

tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël"

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2025 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre

Kjo kerkese eshte vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar.

Kapaciteti teknik :

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

-Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartazi, vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer).

-Kontratë sipërmarrje;

-Situacion përfundimtar;

-Faturat tatimore për këtë situacion **të deklaruara në organet tatimore;**

-Aktin e kolaudit;

-Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

-Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer).

-Kontratë sipërmarrje;

-Situacion përfundimtar;

-Faturat tatimore për këtë situacion **të deklaruara në organet tatimore;**

-Akt kolaudimi objekti.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet .

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën oferten të kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojes realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (a dhe b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, **autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin**

kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe sa dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.***

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qënë palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qënë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjell kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotësuar sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë* në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

N.P – 1 A Punime gjërmimi në tokë

N.P – 4 B Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale

N.P – 7 A Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje

Për punimet speciale të ndërtimit

NS – 6 A Sinjalistikë rrugore jondriçuese

NS – 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore

NS – 9 A Punime strukturore speciale

NS – 18 A Punime topogjodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka

të drejtë të ushtrijë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

NP-1 A Punime gjërmimi në tokë

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjërmimi në tokë konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjërmimi dhe sistemimi të dherave si rezultat i rivitalizimit urban të rrugëve . Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjërmimit të dheut.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime që përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

Këto punime janë parashikuar në preventiv, si shtrese stabilizant t=10cm, shtrese çakelli etj. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuar, të cilët zotërojnë licensën N.P – 4. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.P - 7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi,

furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Sic janë : F.V tuba te brinjezuar HDPE, Tombino me tuba betoni etj. Per sa me siper ne total vlerat për realizimin dhe kompletimin me strukturat e nevojshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

N.S - 6 A *Sinjalistika rrugore jo ndricuese*

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondricuese, vertikale, horizontale dhe komplementare

Këto punime janë parashikuar në preventiv. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuar, të cilët zotërojnë licensën N.S – 6. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.S – 7 A *Barriera dhe mbrojtje rrugore*

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, në jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

Këto punime janë parashikuar në preventiv. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuar, të cilët zotërojnë licensën N.S – 7. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.S- 9 Punime strukturore speciale

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Këto punime janë parashikuar në preventiv. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuar, të cilët zotërojnë licensën N.S – 9. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.S - 18 A *Punime topogjeodezike.*

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Pika e liçencës për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësimin e gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në çdo faze të zbatimit të punimeve. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin,

preventivin dhe specififikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontratës. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP - 1	<i>Punime gjërmimi në tokë</i>	Gërmim dhe me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ , në kanale gjëresi > 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjëresi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në tokë Transport materiale ndërtimi, dhe me auto deri 2.0 km	A (0 – 20 milion lekë)	763.658,9
NP – 4	<i>(Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale)</i>	Shtrese çakelli mbeturinë kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese çakelli t=8cm, përhapur e ngjeshur me makineri Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri	B (20 – 50 milion lekë)	49.221.963
NP – 7	<i>Ujësjellës, kanalizime,</i>	F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=315 mm	A (0 – 20 milion lekë)	205.165,4

	vepra kullimi e vaditje	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni		
NS – 6	(Sinjalistika rrugore jondriçuese)	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 12 cm, Akrelike F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm	A (0 – 20 milion lekë)	1.204.872,65
N.S- 7	Barriera dhe mbrojtje rrugore	F.V. Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane, W2	A (0 – 20 milion lekë)	605.779
NS - 9	Punime strukture speciale		A (0 – 20 milion lekë)	252.236,55
NS - 18	(Punime topogjeodezike)	RILEVIM TOPOGRAFIK, Ne referim termat e references	A (0 – 20 milion lekë)	

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”. si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (te ndryshuar).

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjесimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje, germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si Stacionim transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet, per mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshem i tyre.

Kërkesa per Licence I.2.A është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e proceseve te punes te parashikuara ne preventivin objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) ing Topograf/ Gjeodet/Markshajder

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune
- Diplomë universitare
- Librezë pune
- CV

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.)

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe ka kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NP-1A, NP-4B, NS-6A, NS-7A, NS9A
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe ka kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NP-7A
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe ka kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NS-18A

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate

Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt).

Argumentim: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e

Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- **1 (një) Teknik Ndërtimi** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent si dhe kontratën individuale të punës.

- **2 (dy) Hidraulik** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent si dhe kontratën individuale të punës.

- **2 (dy) Bojaxhi** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent si dhe kontratën individuale të punës.

- **1 (një) Betonues** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent si dhe kontratën individuale të punës.

- **1 (një) Karpentier** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent si dhe kontratën individuale të punës.

- **1 (një) Specialist konstruksione metalike** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent si dhe kontratën individuale të punës.

- **1 (një) Mekanik** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent si dhe kontratën individuale të punës.

- **1 (një) Saldatori** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent si dhe kontratën individuale të punës.

- **2 (dy) Manovratorë Automakiniste** të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmite e aftësi profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme, kontratë individuale pune dhe të figurojnë në listepagesa të pakten tre muajt e fundit dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listpagesat e operatorit ekonomik ofertues

- **2 (dy) Manovratorë Eskavatoriste** me deshmie aftësie nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme, kontratë individuale pune dhe të figurojnë në listepagesa të pakten tre muajt e fundit dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listpagesat e operatorit ekonomik ofertues

2 (dy) shofer kamioni të pajisur me lejen e drejtimit përkatëse nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme, kontratë individuale pune dhe të figurojnë në listepagesa të pakten tre muajt e fundit dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listpagesat e operatorit ekonomik ofertues

- Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

Nr.	Emër Mbiemër punonjësit	Profesioni	Nr amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					

etj					
-----	--	--	--	--	--

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të disponojë stafin e sipërcituar në varësi të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas ndarjes së punimeve.).

Argumentimi: Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash dhe parketesh, lysterje me bojë etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

Teknik ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

-Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet hidraulike etj është kërkuar 1 (nje) teknik ndërtimi . Prania e teknikut është e nevojshme për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve. Kërkesa për 1 (nje) Teknik Ndërtimi është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve dhe grafikun e punimeve.

Hidraulik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

-Për realizimin e punimeve hidraulike në objekt janë kërkuar 2 (dy) hidraulikë. Hidrauliku sipas Listës Shqiptare të Profesioneve merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujësjellës kanalizimeve, të sistemit të ujitjes, sistemeve të ngrohje-ftohjes, të sistemeve hidraulike të objekteve të prodhimit industrial dhe objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai monton, instalon, riparon dhe

mirëmban pajisjet dhe aksesorët për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të sistemeve të ngrohje-ftohjes, pajisje pneumatike etj. Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure parashikon punime për montimin dhe instalimin e rrjeteve dhe pajisjeve të furnizimit me ujë dhe shkarkimeve, si dhe pajisjeve të ngrohje ftohjes. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zerat e punimeve hidraulike në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 duhen gjithësej 2 specialiste hidraulik. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve

Bojaxhi është i nevojshëm për realizimin e punimeve të vijeve të rrugës sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

-Për punimet e bojatisjeve të jashtme të fushës së basketbollit dhe vijeve të rrugës AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) bojaxhi. Sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, bojaxhiu dhe të tjerë që lidhen me to merret me përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lyerje, lyerjen dhe dekorimin e sipërfaqeve të ndryshme sipas projekteve dhe kërkesave të klientëve. Ai mund të vendosë shtresa të materialeve mbrojtëse dhe dekorative të ngjashme ose të mbulojë mure të brendshme dhe tavane të ndërtesave me tapiceri dhe materiale të ndryshme si: letër, mëndafsh, stof e të tjera. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zerat e punimeve të bojatisjes në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 duhen gjithësej 2 specialiste bojaxhinj. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punës.

Betonuesi është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të betonimit në objekt, sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

Karpentieri është i nevojshëm për përgatitjen e kallëpeve të betonit dhe skelerive sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

Gjithashtu punimet e betonit dhe b/a të parashikuara në projektin konstruktiv, specifikimet teknike, preventivin dhe grafikun e punimeve lidhen ngushtë me proceset e derdhjes së betonit, pjesë e të cilave është edhe përgatitja e kallëpeve. Për realizimin e punimeve të tilla është e nevojshme që OE të zotërojë minimalisht 1 (një) punëtor të kualifikuar për realizimin e tyre, karpentier dhe 1 (një) specialist betonues. Sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, të tillë punëtorë realizojnë punime të tilla si kryerjen e matjeve dhe prerjeve sipas përmasave të përcaktuara në projekt, bëjnë piketimin dhe armaturën anësore të themelit, bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit sipas projektit, ndërtojnë armaturën, kallëpet e kolonave, mureve, shkallëve, urave apo strukturave të tjera, duke respektuar radhën e punës, me materiale druri, plastike, apo metalike sipas specifikimeve teknike, montojnë skelerinë përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, kontrollojnë vertikalishtet e armaturës (peshon) me plumbçe, nxjerrin kuotat e lartësisë së katit sipas projektit (para betonimit), lagin armaturën para betonimit, ndërtojnë skelën për armaturën e trarëve dhe soletës duke ndjekur proceset e tjera të punës, vendosin polisterolin ose tullat në soletë apo në struktura të tjera (për rastin e soletave të lehtësuara), bëjnë disarmimin e kolonave, mureve dhe soletës apo strukturave të tjera duke respektuar afatet e duhura, kryejnë pastrimin dhe sistemimin e armaturës etj.

Konkretisht per kryerjen e punimeve per zerat e punimeve te hekurit ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 duhen gjithesej 2 specialiste nga te cilet 1 specialist betonues dhe 1 specialist karpentiere

Kërkesa që OE të ketë të punësuar minimalisht 1 (nje) betonues dhe 1 (nje) karpentier, është kërkesë minimale në raport me vëllimin e punimeve.

Saldatori është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te saldimi ne sektore te ndryshme si konstruksione metalike, tuba metalike, etj, si pjese integrale e realizimit te zërave te punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

-Për saldimin e elementëve metalikë nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 1 (nje) saldatori. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon realizime te strukturave metalike, siç janë stolat dekorative, porta metalike per territorin e jashtem, konstruksione metalike etj. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 duhen gjithesej 1 specialist saldator. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit.

Mekanik është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te ndryshme si konstruksione metalike, shtylla metalike, etj, si pjese integrale e realizimit te zërave te punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

Përspostimin dhe vendosjen e shtyllave metalikë nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 1 (nje) mekaniku. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 duhen gjithesej 1 specialist mekanik. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit

Specialist konstruksione metalike është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te konstruksioneve metalike , sipas zërave te punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 duhen gjithesej 1 specialist konstruksionesh *metalike*. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit

Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023. *Bazuar ne kater elementet e struktures se koston(material, puntori, makineri, transport).* Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e

kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore

Vendosja e këtij kriteri lidhet drejtpërdrejtë me mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

Për manovrimin e makinerive mbi bazë automjeti, ku përfshihen autovinça, autobitumatrice, asfaltoshtruese, rrul është kërkuar kategoria e punonjësve të kualifikuar automakinst.

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1c që përcakton se, *automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.*

Për manovrimin e makinerive të gërmimit dhe ngarkimit të dherave ku përfshihen minifadromat dhe fadromat e llojeve të ndryshme dhe eskavatorët e ndryshëm janë kërkuar eskavatoristë.

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1a, sipas së cilës, *eskavator gërmimi e ngarkimi dherash:- të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST.*

Për punimet e gërmimit do të punojnë një eksavatorë me zinxhir. Për këtë arsye do të nevojitet një eskavatorist. Duke patur parasysh volumet e punes dhe përdorimin e eskavatorit sipas nevojave eshte e mjaftueshme kerkesa per 2 (dy) eskavatoristë

Kjo kërkesë është minimale në raport me punën e nevojshme. Kujtojmë se sipas nenit 17 të urdhrit më sipër cituar, *për të mundësuar lëvizjen në rrugë dhe për të shmangur aksidentet, mjetet për të cilat bën fjalë neni 8 i kësaj rregulloreje duhet të qarkullojnë në përputhje me përcaktimet e nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.* Ndërsa referuar nenit 8, pika 2, të po këtij akti, *për lëvizjen apo qarkullimin në rrugë, makineritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nëse janë të pajisura me rrota pneumatike, duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 113 dhe 122 të Kodit Rrugor, kurse drejtuesit e tyre, në varësi të makinerisë, duhet të jenë të pajisur me kategorinë përkatëse të lejedrejtimit.*

Për realizimin e punimeve ndërtimore për zbatimin e projektit, janë parashikuar këto makineri mbi bazë automjeti:

Për manovrimin e autovinçit, nje autobitumatrice, nje asfaltoshtruese, nje rruli me vibrim, nje autobot uji dhe një vinc kulle, Për manovrimin e të cilave janë kërkuar 2 (dy) automakinistë. Ky numër automakinistësh është kërkuar minimal në raport me nevojat, duke patur për qëllim rritjen e pjesëmarrjes. Proceset e lidhura me këto automjete janë thuajse të njëkohëshme. Përdorimi i ketyre makinerive mund të alternohet sipas programit të punës për zbatimin e kontratës.

Gjithashtu për përdorimin e kamioncinave është kërkuar 2 (dy) shofere. Ky numër shoferesh është kërkuar minimal në raport me nevojat, duke patur për qëllim rritjen e pjesëmarrjes.

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre :

- a) **1 (një) punonjës** i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet ta ketë pjesë të stafit të tij.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”*.

Argumentimi : Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës

në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) punonjës të siguruar për 3 (tre) mujorin e fundit (duke përfshirë edhe stafin teknik të sipërcituar). Për t'a vërtetuar këtë duhet të paraqesë :

a) Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore.\

b) Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasitë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej 12.941.5 orë pune punëtori dhe 920.51 orë pune makineri, për të cilat nevojiten 35 (20+15) punonjës, ku përfshirë dhe stafin teknik të nevojiten dhe manovratore/shofere në total të paktën 35 (tridhjetë e pesë) punonjës.

Nr	Kodi	Emertimi I punimeve	Njesia	Sasia	ore pune/njesi	ore pune total
		1. Te Ndryshme, Elektrike dhe Sinjalistika				
1	3,183	F.V. Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane, W2	ml	100.00	1.74	174.00
2	3.164/1t	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	copë	30.00	1.5	45.00
		2 . Punime germimi				

3	3.104/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	1,750.00		-
4	3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	60.00		-
		3. PUNIME DHEU				
5	2.37/2a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 2.0 km	m3	1,750.00		-
		4. PUNIME SHTREASH				
6	3,211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	17,300.00	0.28	4,844.00
7	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	17,300.00	0.075	1,297.50
8	3,207	Shtrese çakelli t=8cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	3,890.00	0.036	140.04
		5. ANALIZA TEKNIKE				
9	3.229/1	Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri	m2	13,500.00	0.109	1,471.50
10	3.231/1	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri	m2	13,500.00	0.082	1,107.00
		6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT + KANALIZIME				
11	3,365	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni	m	20.00	4.4	88.00
		7. Punime Betoni e Betonarmeje				
12	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25	m3	15.00	12.8	192.00
		8.B. Sinjalet Horizontale				
13	3.942/2	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Akrelike	ml	7,780.00	0.1	778.00
		9. D. Sinjalet dhe Pajisjet Shtese. Ngadalesuesit e Shpejtesise				
14	3,955	F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	5.00	0.5	2.50
Ore pune ne total per kryerjen e punimeve				Referuar Normatives sipas Manualit te Ndertimit		10,139.54
			Dite pune 8 orarshe ne total			1267.4425
Peruidha ne dite per kryerjen e punimeve sipas grafikut eshte 5 muaj				21 dite pune/muaj * 6 muaj		126
Numri i fuqise punetore per kryerjen e punimeve				dite pune total / 88		10.059067
Numri i specialisteve te nevojshem				15		15
Numri total i fuqise punetore per kryerjen e punimeve						25.059067

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Spërkatës boje	copë 1	Në pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	copë 1	Në pronësi ose me qira
Grejder	copë 1	Në pronësi ose me qira
Rul me Vibrim	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobot uji	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator 0,5 m3	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator 0,25 m3	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vinc kulle 4-6 T	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vinc ekskavator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinc deri 2.5 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 Ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamion me kapacitet mbajtës 3.5-10 Ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Makineri per montim guard rail	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vibrator thellësie	copë 1	Në pronësi ose me qira
Betonjere	copë 2	Në pronësi ose me qira
Kokore	copë 25	Në pronësi ose me qira
Jelek	copë 25	Në pronësi ose me qira
Tabela sinjalizuese rrugore	copë 10	Në pronësi ose me qira
Kuti ndihme e shpejtë	copë 5	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë :

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:**
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) e vlefshme
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
 - f) Tahograf për mjetet që e disponojnë (i vlefshëm)
 - g) Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm)
 - h) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:**

- a) Kontrata e qerasë
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) (e vlefshme)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
 - f) Tahograf për mjetet që e disponojnë (i vlefshëm)
 - g) Çertifikatë transporti nga njësia vendore (për transport mallrash për të tretë dhe me qera); (e vlefshme)
 - h) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (**fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira**).
 - Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
 - Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës së makinerive.
 - Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. **Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi.** Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
 - Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Nr	Emertimi punimeve I	Sasia	Mjete dhe vegla			ore pune/njesi Mjetet			ore pune total Mjetet
	1. Te Ndryshme, Elektrike dhe Sinjalistika								
1	F.V. Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane, W2	100.00	Makineri per montim guard rail			0.3			30.00
2	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	30.00							-
	shuma 1:								
	2 . Punime germimi								
3	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, token zak, kategoria IV,	1,750.00	Ekskavator 0.5 m3			0.053			92.75

	me shk ne mjet										
4	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	60.00	Ekskavator 0.25 m3			0.094			5.64		
	shuma2										
	3. PUNIME DHEU										
5	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 2.0 km	1,750.00							-		
	SHUMA3:										
	4. PUNIME SHTREASH										
6	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	17,300.00	Grejder	Rul (kompresor) me vibrim		0.025		0.24	432.50	4,152.00	
7	Shtrese stabilizant t=10cm	17,300.00	Grejder	Autobot	Rul (kompresor) me vibrim	0.015	0.018	0.04	259.50	311.40	692.00
8	Shtrese çakelli t=8cm, perhapur e ngjeshur me makineri	3,890.00	Grejder	Rul (kompresor) me vibrim		0.02	0.024		77.80	93.36	
	SHUMA 4:										
	5. ANALIZA TEKNIKE										
9	Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri	13,500.00	Autobitumatriçe	Asfalto shtrues e	Rul (kompresor) me vibrim	0.001	0.01	0.01	13.50	135.00	135.00

10	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri	13,500.00	Autobitumatriçe	Asfalto shtrues e	Rul (kompr esor) me vibrim	0.001	0.007	0.007	13.50	94.50	94.50
6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT + KANALIZIME											
11	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni	20.00							-		
7. Punime Betoni e Betonarmeje											
12	Struktura te holla monolite betoni C 20/25	15.00	Vibrator thellesie	Betonje re 500 liter		1.64	0.65		24.60	9.75	
8.B. Sinjalet Horizontale											
13	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Akrelike	7,780.00	Sperkate s boje per vizime ne rruge			0.1			778.00		
9. D. Sinjalet dhe Pajisjet Shtese. Ngadalesuesit e Shpejtesise											
14	F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm	5.00							-		

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
- BS ISO 39001:2012 Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatat e mësipërme) .Çertifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht skualifikimi.

Argumentimi:Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi,

i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

BS ISO 39001:2012 Kjo çertifikatë mundëson që kompanitë të punojnë me sistemet e qarkullimit rrugor, të reduktojnë dhe të përjashtojnë rreziqet e humbjes të jetes dhe plagosjeve në lidhje me aksidentet gjatë procesit të punës.

2.3.11 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materialet hidraulike (tuba te brinjezuar)
- Boje bikomponente spray

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin(kontratë/autorizim)që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të shoqërohet me certifikaten e cilësisë sipas Standartit ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise) te prodhuesit, e vlefshme

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë e dhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve.Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet sherbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.12. Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e meposhtme duhet te paraqiten skeda teknike dhe te nenvizohen ne katalog sipas specifikimeve te mesiperme per :

Tubat e brinjezuar HDPE. Tubat e brinjezuar HDPE duhet të jenë nga material polietileni, me densitet të lartë, në përputhje me standartin SSH/DIN/EN 13476 dhe SSH/DIN/EN 1610 ose ekuivalente.Tubat duhet te kene fleksibilitet te mire dhe veti te mira hidraulike dhe mekanike .Duhet te jene te pershtatshme per te gjitha punimet ne sisitemet e kullimit dhe ujerave te zeza per instalime nentokesore me rezistence te larte kimike sipas klasifikimit te standartit SSH/DIN/EN/ISO 10358 ose ekuivalente.Gjatesia e tubave duhet te kete gjatesi standarte 6m

dhe bashkimi i tyre te jete me bashkues me gomine EPDM ose SAG Tubat duhet te kene keto karakteristika. Materiali:HDPE Standarti: SSH/DIN/EN 4262/1 ose ekuivalente Dendesia: $>0.945 \text{ kg/m}^3$ Moduli i elasticitetit: $>800 \text{ MPa}$ Koficenti i zgjerimit termik linear: $<0.17 \text{ mm/m } ^\circ\text{K}$ Koficenti i percjellshmerise termike: $23 \text{ } ^\circ\text{C} \sim 0.36-0.5 \text{ W/mk}$ Temperatura e Aplikimit: -40°C $+60^\circ\text{C}$ Rezistenca elektrike siperfaqesore: $>1013\Omega$ Forca e unazes:Sipas standartit SSH/DIN/EN/ISO 9969 ose ekuivalente. Ngjyra: E zeze Tubat hdpe te brinjezuar duhet te jene te certifikuar nga nje insitucion Nderkombetar ose Kombetar i akredituar,e cila te vertetoj qe tubat hdpe korrogato jane projektuar per kullime nentokesore nenpresion ne sisitemet e kanalizimeve. Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Boje Bikomponente Spray Bojë sinjalistike dy komponente me bazë metil metakrilati për vizimin e rrugëve, fushave sportive etj Densiteti: $1.75 \pm 0.06 \text{ kg/dm}^3$ (200C) Përmbajtje solide: Minimumi 99.8 peshë % pas hedhjes së katalizatorit dhe përfundimit të reaksionit. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH/DIN/EN/ISO 12802 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me SSH/DIN/EN/ISO 17025 ose ekuivalente.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë e dhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve.Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet sherbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Gjithashtu në bazë të nenit 4, nenit 36 si dhe nenit 79 pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 .Ky kriter eshte vendosur qe

AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates

Në nenin 44 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojë qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën objekt prokurimi, janë hartuar nga struktura përkatëse që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qenë element përbërës i tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të ligjit nr.9290, datë 07.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, i ndryshuar dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, si dhe kërkesat e ligjit nr.10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Afati i ekzekutimit të punimeve: 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT